

“KALO & ASSOCIATES” SHPK

Pasqyrat Financiare

Për ushtrimin e mbyllur më
31 Dhjetor 2024



PERMBAJTJA:

RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR	2
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI) BILANCI KONTABËL	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E TË ARDHURAVE E SHPENZIMEVE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN E VET	5
4. MJETE MONETARE	11
5. KLIENTE DHE KËRKESA TË ARKËTUESHME	12
6. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA	12
7. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE	12
8. HUATE DHE PARAPAGIMET AFATSHKURTRA	12
9. SHITJE NETO	12
10. KOSTO TE PUNES	14
11. SHPENZIME TË TJERA	15
12. TE ARDHURA TE TJERA	15
13. SHPENZIME FINANCIARE	15
14. TATIM MBI FITIMIN	16
15. SHPENZIME TE PAZBRITSHME	16

“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI) BILANCI KONTABËL

Bilanci	Shenime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktivet			
Aktivet afatshkurtra			
Mjete monetare		5,287,354	5,499,672
Llogari të arkëtueshme tregtare		27,429,099	25,672,674
Llogari të arkëtueshme nga palet e lidhura		13,124,140	9,672,674
Te tjera llogari te arketueshme		2,376,294	1,550,190
Totali i aktiveve afatshkurta		48,216,887	42,367,199
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata material		4,585,930	5,724,124
Totali i aktiveve afatgjata		4,585,930	5,724,124
Totali i aktiveve		52,802,817	48,091,323
Detyrimet dhe kapitali			
Detyrimet afatshkurtra			
Huat afatshkurta		10,000,000	-
Llogari te pagueshme tregtare		2,026,825	1,717,041
Detyrimet tatimore		1,233,746	887,082
Te tjera detyrime		1,009,962	926,658
Te pagueshme te tjera		-	4,293,881
Totali i detyrimeve afatshkurtra		14,270,533	7,824,662
Detyrimet afatgjata			
Te tjera detyrime		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		14,270,533	7,824,662
Kapitali			
Kapitali aksioner		6,800,000	6,800,000
Rezervat statutore dhe ligjore		1,307,570	1,307,570
Rezerva te tjera		(0)	(0)
Fitimi I Pashperndare		26,171,191	16,097,902
Fitimi (humbja) e vitit		4,253,523	16,061,189
Total kapitali		38,532,284	40,266,661
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		52,802,817	48,091,323

Pasqyrat duhet te interpretohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6-15.

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2024 u pergatiten nga **Majlinda Kraja**,u aprovuau nga **Eni Kalo** dhe u nenshkrua si me poshte:

Eni Kalo

Majlinda Kraja



“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024

PASQYRA E PERFORMANCËS
PASQYRA E TË ARDHURAVE E SHPENZIMEVE
Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor, 2024

PERSHKRIMI	Shenime	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2024	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2023
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit		76,606,301	91,066,156
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit			
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme ,			
sherbime dhe te tjera shpenzime			
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme			
2) Të tjera shpenzime			
Shpenzime te personelit		(29,039,588)	(25,934,199)
1) Paga dhe shpërblime		(25,535,735)	(22,753,469)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore		(3,503,853)	(3,180,730)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		(1,084,617)	(1,466,778)
Shpenzime të tjera shfrytezimi		(48,664,936)	(52,493,306)
Të ardhura të tjera		6,793,453	7,250,512
Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		6,793,453	7,250,512
Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve			
financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra			
Shpenzime financiare		(357,090)	(738,769)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme			
2) Shpenzime të tjera financiare		(357,090)	(738,769)
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		-	-
Fitimi/Humbja e vitit		4,253,523	17,683,616
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin			(1,622,427)
1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin			
2 Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë		-	-
3 Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve			
Fitimi/Humbja e vitit		4,253,523	16,061,189
Fitimi/Humbja për:			
Pronarët e njësisë ekonomike mëmë			
Interesat jo-kontrolluese			

Pasqyrat duhet te interpretohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6-15.

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2024 u pergatiten nga **Majlinda Kraja**,u aprovuan nga **Eni Kalo** dhe u nenshkrua si me poshte:

Eni Kalo



Majlinda Kraja



“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN E VET
Për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor, 2024

	Kapitali i nenshkruar	Rezerva Ligjore	Fitime Humbje te mbartura	Total
Bilanci date 31 Dhjetor 2019	6,800,000	1,307,570	29,452,876	37,560,446
Bilanci date 1 Janar 2020	6,800,000	1,307,570	29,452,875	29,452,875
Emetim I kapitalit aksionar	-	-	-	-
Divident i paguar			(16,017,113)	(16,017,113)
Fitim Humbje te mbartura		-	-	-
Humbje / Fitim per periudhen	-		25,608,281	25,608,281
Bilanci date 31 Dhjetor 2020	6,800,000	1,307,570	39,044,043	47,151,613
Bilanci date 1 Janar 2021	6,800,000	1,307,570	39,044,043	47,151,613
Emetim I kapitalit aksionar	-	-	-	-
Divident i paguar			(23,445,438)	(23,445,438)
Fitim Humbje te mbartura		-	-	-
Humbje / Fitim per periudhen	-		30,469,681	30,469,681
Bilanci date 31 Dhjetor 2021	6,800,000	1,307,570	46,068,287	54,175,857
Bilanci date 1 Janar 2022	6,800,000	1,307,570	46,068,287	54,175,857
Emetim I kapitalit aksionar	-	-	-	-
Divident i paguar			(46,068,287)	(46,068,287)
Fitim Humbje te mbartura		-	-	-
Humbje / Fitim per periudhen	-		23,761,677	23,761,677
Bilanci date 31 Dhjetor 2022	6,800,000	1,307,570	23,761,677	31,869,247
Bilanci date 1 Janar 2023	6,800,000	1,307,570	23,761,677	31,869,247
Emetim I kapitalit aksionar	-	-	-	-
Divident i paguar			(7,663,775)	(7,663,775)
Fitim Humbje te mbartura		-	-	-
Humbje / Fitim per periudhen	-		16,061,189	16,061,189
Bilanci date 31 Dhjetor 2023	6,800,000	1,307,570	32,159,091	40,266,661
Bilanci date 1 Janar 2024	6,800,000	1,307,570	23,761,677	31,869,247
Emetim I kapitalit aksionar	-	-	-	-
Divident i paguar			(5,987,900)	(5,987,900)
Fitim Humbje te mbartura		-	-	-
Humbje / Fitim per periudhen	-		4,253,523	4,253,523
Bilanci date 31 Dhjetor 2024	6,800,000	1,307,570	30,424,714	38,532,284

“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare
 Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023
Fitim / Humbja e vitit	4,253,523	16,061,189
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	1,084,617	1,466,778
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(6,062,006)	(11,598,070)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	6,362,567	(2,444,994)
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	83,304	66,229
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit	5,722,005	3,551,132
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	53,577	(240,926)
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jo materiale	-	-
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e investimit	53,577	(240,926)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga / përdorur në aktivitetin e financimit		
a. Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	-	-
c. Hua të arkëtuara	-	-
d. Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë	-	-
j. Dividendë të paguar (personi fizik terheq)	(5,987,900)	(7,663,775)
Mjete monetare neto nga / përdorur në aktivitetin e financimit	(5,987,900)	(7,663,775)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(212,318)	(4,353,569)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar 22	5,499,672	9,853,241
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor 22	5,287,354	5,499,672

Pasqyrat duhet te interpretohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6-15.

Pasqyrat financiare të kompanisë për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2024 u pergatiten nga **Majlinda Kraja**,u aprovuan nga **Eni Kalo** dhe u nenshkrua si me poshte:

Eni Kalo



Majlinda Kraja

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

“Kalo & Associates” shpk (shoqeria) është krijuar si me vendim te Gjykates së rrethit Tiranë e regjistruar në regjistrin tregtar nr. 33260 datë 29/03/2005, në përputhje me ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” nr.9901 datë 14/04/2008.

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është: Ofrimi i shërbimeve ligjore, personave fizike dhe juridike, shqiptare apo te huaj, keshillimi, përgatitja e dokumentave ligjore si dhe përfaqësimi ne gjykate dhe perpara organeve te tjere shtetore e institucioneve te tjera.

Administrator i shoqërisë është Znj. Eni Kalo

Selia e shoqërisë është Rruga e Kavajes, Ndertesa nr. 27, Kati 5, Njesia bashkiake nr. 10 Tiranë. Shoqëria është e regjistruar në Njesisë e Tatim paguesve dega Tiranë me NUIS: K 31910009 D. Numri i punonjesve me dt 31.12.2024 eshte 13

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE

a. Bazat e përgatitjes se pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare jane përgatitur, ne te gjithe aspektet materiale, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te përmirësuar, te cilat perbehen nga rregullat dhe interpretimet ne perputhje me Ligjin Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin Dhe Pasqyrat Financiare “

Pasqyrat financiare jane përgatitur mbi bazen e kostos historike. Te dhenat aktuale dhe krahasuese jane prezantuar ne Lek Shqiptare (LEK), qe eshte monedha raportuese e shoqërise.

b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

c. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

d. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varësi te ketyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel janë të njohura ne periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në vecanti, informacion mbi fushtat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtëme janë aplikuar ne menyre konsistente ne te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat financiare.

a. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare te paraqitura ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes se transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e gjendjeve te bilancit emertuar ne monedhe ne huaj jane si me poshte (ne LEK):

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
1 EUR	98.15	103.88
1 USD	94.26	93.94

b. Instrumenta financiar

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme. Gjatë periudhës së raportuar nuk ka patur investime në kapital apo instrumenta borxhi të përdorura gjatë aktivitetit.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimë të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi financiar, dhe mospagesa apo kundravajtje në pagesa (mbi 30 ditë vonesë) konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e

“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024

provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huaatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv .

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksioner

Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale. Aksionet e preferuara të detyrueshme me të drejtë riblerjeje klasifikohen si detyrime.

c. Aktive e afatgjata materiale dhe jomateriale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit mbarten në “Ndërtim në proces” dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afat-gjate materiale kane jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afat-gjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivit afat-gjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024

Normat vjetore te amortizimit te perdorura jane si me poshte:

Kategoria	Norma e amortizimit %		Metoda e llogaritjes
	2019	2018	
Instalime	20	20	Vlera kontabile e mbetur
Mjete transporti	20	20	
Mobilje orendi	20	20	
Paisje elektronike	25	25	

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në cdo date raportimi.

d. Zhvlerësimi

(i) aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Cdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivët afatgjata materiale dhe jomateriale janë njohur si të tilla nëse parashikohet që shoqëria do të ketë perfitime të ardhshme ekonomike që kanë lidhje me atë aktiv dhe kosto e aktivit mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera e mbajtjes së aktiveve të qëndrueshme duhet të rishikohet nëse është zhvlerësuar kur ndodhin ndryshime ose ndryshime në rethanat tregojnë se vlera e mbajtjes mund të jetë e parikuperueshme. Nëse këto të dhëna ekzistojnë dhe atëherë kur vlera e mbajtjes kalon vlerën e parashikuar të rikuperueshme, aktivi zhvlerësohet në vlerën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

e. Njohja e te ardhurave dhe shpenzimet

Te ardhurat jane njohur atehere kur shoqeria do te kete te mundur te marre perfitime ekonomike dhe keto perfitime mund te vleresohen me siguri (dhe jo domosdoshmerisht kur eshte arketuar). Shpenzimet jane njohur ne pasqyren e te ardhura-shpenzimeve atehere kur kane ndodhur (dhe jo domosdoshmerisht kur eshte paguar). Te ardhurat dhe shpenzimet jane regjistruar ne pasqyrat financiare te periudhes se ciles ato i perkasin.

f. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e të drejtave dhe detyrimeve te konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare te mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv

g. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin jane llogaritur ne perputhje me dispozitat e ligjit per tatimin mbi te ardhurat ne Republiken e Shqiperise. Shpenzimet per tatimin mbi fitimin perfshijne gjithë detyrimet per tatimin mbi fitimin e ketij vitit ushtrimor. Tatimi mbi fitimin i ketij viti ushtrimor eshte - llogaritur me 15% fitimit te tatueshem sipas normave fiskale ne Shqiperi.

4. MJETE MONETARE

Arka, banka dhe likuiditete të tjera analitikisht me 31 Dhjetor 2024, 2023 jane:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2024	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2023
Vlera monetare arka	469,665	793,212
Vlera monetare banka	4,817,689	4,706,460
Depozita	-	-
TOTALI	5,287,354	5,499,672

“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024

5. LLOGARI TE ARKETUESHME TREGTARE

Llogarite e arketueshme tregtare me 31 Dhjetor 2024, 2023 paraqiten si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2024	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2023
Kliente	27,429,099	25,644,663
TOTALI	27,429,099	25,644,663

6. LLOGARI TË ARKËTUESHME NGA PALET E LIDHURA

Llogarite e arketueshme nga palet e lidhura me 31 Dhjetor 2024, 2023 paraqiten si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2024	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2023
Paradhenie/Kosova	9,952,524	9,672,674
Paradhenie ortaket	3,171,616	-
TOTALI	13,124,140	9,672,674

7. TE TJERA LLOGARI TE ARKETUESHME

Te tjera llogari te arketueshme me 31 Dhjetor 2024, 2023 paraqiten si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2024	Viti I mbyllur me 31 dhjetor 2023
Tatim fitimi	2,376,294	1,550,190
TOTALI	2,376,294	1,550,190

8. LLOGARI TE PAGUESHME TREGTARE

Llogari te pagueshme tregtare me 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë përbërë si me poshtë:

	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2024	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2023
Furnitore per mallra , produkte e sherbime	2,026,825	1,717,041
TOTALI	2,026,825	1,717,041

9. DETYRIMET TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë përbërë si me poshtë:

	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2024	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2023
Sigurime shoqerore dhe shendetsore dhe tap	1,009,962	926,658
TVSH	1,233,746	887,082
Tatim ne Burim	-	-
TOTALI	2,243,708	1,813,740

10. TE TJERA DETYRIME

Te tjera detyrime më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë përbërë si me poshtë:

	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2024	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2023
Paradhenie/Kosova	-	-
Paradhenie ortaket	-	4,293,881
HUA te tjera	10,000,000	-
TOTALI	10,000,000	4,293,881

11. KAPITALI

Kapitali i shoqerise per vitin 2024 eshte 6,800,000 leke.

12. TE ARDHURAT NGA AKTIVITETI I SHFRYTEZIMIT

Te ardhurat nga aktiviteti i shrytezimit per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023, jane si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2024	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2023
Sherbime Ligjore	76,606,301	91,066,156
Te tjera	-	-
TOTAL	76,606,301	91,066,156

“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024

13. LËNDA E PARË DHE MATERIALE TË KONSUMUESHME , SHERBIME DHE TE TJERA SHPENZIME

Ne kete ze paraqitet kostoja e mallrave, lendeve te para dhe sherbimeve te konsumuara qe lidhen me veprimtarine e shfrytezimit. Lendet e para, materiale te konsumueshme dhe sherbime te tjera per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 jane si me poshte:

	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2023	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2023
Blerje energji	273,251	389,500
Blerje Telefon /internet	1,706,149	2,015,463
Shpenzim transporti	1,616,093	1,156,743
Pagesa per bashkepunetoret	1,475,921	1,549,062
Antaresime	3,132,485	4,262,192
Kontrate License	3,529,625	3,529,941
Qira	5,422,569	4,547,922
Mirembajtje dhe riparime	2,109,618	1,911,340
Shpenzime kancelarie	674,704	622,895
Perkthime	645,008	1,828,626
shpenzime noterie	474,400	591,633
Shpenzime per Klientet	5,792,782	2,556,953
Shpenz per koncesione, patenta, licensa dhe te ngjashme	62,500	42,000
Transferime, udhetim, dieta	1,487,767	2,793,327
Shpenzime postare	114,296	145,393
Sherbime bankare	351,085	419,907
Sherbime ligjore	18,028,650	21,971,439
sigurime jete, profesionale, zjarri etj	301,554	308,569
Taksa Vendore	330,988	49,500
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime	551,666	664,193
Sponsorizime	117,480	234,709
Shpenzime te pazbritshme	32,520	383,076
Shpenzime zyre	377,347	518,861
Shpenzime per interesa	56,481	
TOTAL	48,664,936	52,493,244

“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024

14. SHPENZIME TE PERSONELIT

Shpenzimet e personelit per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 jane si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2024	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2023
Pagat dhe shperblimet e personelit	25,535,735	22,753,469
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	3,503,853	3,180,730
TOTAL	29,039,588	25,934,199

15. TE ARDHURA TE TJERA

Te ardhura te tjera jane te ardhura te perfituara nga njesia ekonomike ku shoqeria ka interesa pjesemarrese, konkretisht dividend per tu shperndare konkretisht keto te ardhura per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024, 2023 jane:

	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2024	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2023
Divident nga pjesemarjet	6,793,453	7,250,512
TOTALI	6,793,453	7,250,512

Bazuar ne Ligjin Nr. 8438, date 28.12.1998, Neni 26, jane te ardhura ushtrimore te patatuara per efekt tatim fitimi.

16. SHPENZIME FINANCIARE

Analitikisht te ardhurat dhe shpenzimet financiare per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 jane si me poshte:

	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2024	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2023
Shpenzime per interesa	-	-
Te ardhura nga interesat	-	-
interesat neto	-	-
Humbje nga kembimet valutore	(357,090)	(968,362)
Fitime nga kembimet valutore		229,593
Fitim humbje/nga konvertimi	(357,090)	(738,769)
TOTAL	(357,090)	(738,769)

“Kalo & Associates” shpk
Shenime te pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024

17. TATIM MBI FITIMIN

Shoqëria ka aplikuar normën e tatim fitimit mbështetur në ligjin për të ardhurat Deklarimi i tatimit mbi fitimin për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2024, 31 Dhjetor 2023 është si më poshtë:

	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2024	Viti I mbyllur me 31 Dhjetor 2023
Fitimi para tatimit	4,253,523	17,683,616
Fitimi I tatueshem perpara tatimit	(2,539,930)	10,433,104
Tatim fitimi i llogaritur me 15%	-	1,564,966
Efekti tatimor i:		
-Te ardhurave Te pa tatueshme	-	-
-Shpenzimeve te pazbritshme per tatim fitimin	-	57,462
Rezultati tatimor	4,253,523	16,061,189
Tatim fitimi total	-	1,622,427

SHPENZIME TE PAZBRITSHME

	2024	2023
Gjoha dhe demshperblime	-	-
Shpenzime te pazbritshme	-	383,076
	-	383,076

18. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Ceshtje gjyqesore

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treat. Bazuar ne opinionin e drejtuesve te Shoqerise, konkluzioni perfundimtar ne lidhje me keto ceshtje nuk do te kete efekte negative ne pozicionin financiar te Shoqerise ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Me 31 Dhjetor 2024 Shoqeria nuk ka asnje ceshtje gjyqesore te hapur kundrejt saj apo nga ajo qe mund te kerkoje rregullime te ketyre pasqyrave financiare.

19. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Nuk ka asnje ngjarje pas dates se bilancit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare